



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0008524-2/26 dt. 16.02.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 21 të Rregullores MF –Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, dhe Propozim – Vendimin Nr. 01-020/04-0008524/26, dt. 12.02.2026, të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë Jo financiare në Komunën e Mitrovicës së Jugut)

1. **FORMOHET** Komisioni për Vlerësimin e Pasurisë Jo financiare në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1 Hashim Berisha – kryetar (Drejtorja për Administratë të Përgjithshme);
 - 1.2 Idriz Gashi – anëtar (Drejtorja për Administratë të Përgjithshme);
 - 1.3 Egzon Aliu – anëtar (Qendra për Punë Sociale).
2. Komisioni i lartcekur është përgjegjës që të bëjë Vlerësimin e pasurisë Jo financiare të organizatës buxhetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
3. Përgjegjësit e Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë Jo financiare në Komunën e Mitrovicës së Jugut janë: Vlerësimi i pasurive të dëmtuara, Vlerësimi i kërkesave për tjetërsim të pasurive, Prezantimi i dëshmimeve për vlerësimin e pasurisë dhe përgatitja e raportit për pasurinë jo financiare që duhet të largohet nga përdorimi. Raporti duhet të dorëzohet Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Kryetarit të Komunës.
4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren MF –Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.



6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr. 01-020/04-0017016-2/25, dt. 01.04.2025 dhe Vendimi Nr. 01.020/04-0034960/25, dt. 19.06.2025.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PEÇI



Shtojcë:

Propozim-Vendimi i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme Nr. 01-020/04-0008524/26, dt. 12.02.2026;
Vendimi Nr. 01-020/04-0017016-2/25, dt. 01.04.2025;
Vendimi Nr. 01.020/04-0034960/25, dt. 19.06.2025.

Ti dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

